



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 65, datë 07.07.2020

PËR

**VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 7 PALLATEVE TË  
NDODHURA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4 DHE NR. 5, DURRËS, TË  
GJITHA PRONË PRIVATE, NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË  
HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 7 pallateve të ndodhura në Njësitë Administrative nr. 4 dhe nr. 5 Durrës, pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë, sipas listës bashkëngjitur.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim<sup>h</sup> hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).



**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.07.2020**

## LISTA E PALLATEVE PER PRISHJE RAJONET / QYTETI DURRES

Nr.	NJESIA / RAJONI	PROT.AKT EKSPERTIZA	NR. KATI	ADRESA	KODI GIS	PRISHJE/RIFORCIM
-----	-----------------	---------------------	----------	--------	----------	------------------

### R-4

1	RAJONI 4	8582. DT 06.07.2020 NR. 1578, DT. 06.07..2020 ISTN	5 KT	120  ALEKSANDER GOGA	20367	PRISHJE
2	RAJONI 4	4155. DT 14.04.2020 NR. 730, DT. 13.03.2020 ISTN	5 KT	130  ALEKSANDER GOGA	20370	PRISHJE

### R-5

3	RAJONI 5	8582. DT 06.07.2020 NR. 1578, DT. 06.07..2020 ISTN	6 KT	1  LURA	4127	PRISHJE
4	RAJONI 5	8582. DT 06.07.2020 NR. 1578, DT. 06.07..2020 ISTN	5 KT	15  AHMET DAKLI	146	PRISHJE
5	RAJONI 5	8578. DT 06.07.2020 NR. 1576, DT. 06.07..2020 ISTN	6 KT	23  AHMET DAKLI	150	PRISHJE
6	RAJONI 5	8582. DT 06.07.2020 NR. 1578, DT. 06.07..2020 ISTN	5 KT	3  LURA	4129	PRISHJE
7	RAJONI 5	8582. DT 06.07.2020 NR. 1578, DT. 06.07..2020 ISTN	5 KT	5  AHMET DAKLI	139 SHTESA	PRISHJE





8840/3

2


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 610/2 prot.



Durrës, më 08.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.65 datë 07.07.2020 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 7 pallateve të ndodhura në njësitë administrative nr. 4 dhe nr. 5, Durrës, të gjitha pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ROLAND NASTO

